

FORMULARI I ANKESËS PRANË AUTORITETIT/ENTIT KONTRAKTOR DHE KOMISIONIT TË PROKURIMIT PUBLIK

Ankesë drejtuar: Autoriteti/Entit Kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik

Seksioni I. Identifikimi i ankimuesit

Ankimuesi mund të jetë një ofertues ose ofertues i mundshëm (p.sh. individ, operator ekonomik, shoqatë, bashkim operatorësh ekonomikë)

Albania Distribution Chemicals

Emri i plotë i ankimuesit (ju lutem shtypeni)

M11815028I

NUIS/NIPT

Rruga e Kavajës, Buka SH.A, Nr.8240, Njësia Nr.6.

Adresa

Tiranë

Albania

1001

Qyteti

Shteti

Kodi Postar/Posta

0694000260

Numri i telefonit (përfshirë kodin e zonës)

Numri i faksit (përfshirë kodin e zonës)

info@adchem.al

E-mail

Administrator Mamica Jançe

Emri dhe titulli i zyrtarit të autorizuar për lëshimin e ankesës (ju lutemi shkruani)

2023/12/21

Nënshkrimi i zyrtarit të autorizuar

Data (viti/muaji/dita)

0694000260

Numri i telefonit (përfshirë kodin e zonës)

Numri i faksit (përfshirë kodin e zonës)

Seksioni II: Informacion mbi procedurën

Numri i referencës së procedurës/Lotit

Plotësoni numrin e referencës së kontratës në njoftimin e kontratës ose në dokumentin e tenderit.

REF-91616-12-19-2023

Tipi i procedurës për ankesën

Procedure Prokurimi Publik

Tipi i ankesës

Dokumenta Tenderi

Plotësoni llojin e procedurës së përdorur

Open INT

Autoriteti/Enti Kontraktor

Emri i autoritetit/entit kontraktor që administrojnë procesin e prokurimit.

SH.A Ujesjelles Kanalizime Tirane

Vlera e përllogaritur e prokurimit

Vlera e përllogaritur e kontratës/Marrëveshjes Kuadër (shuma në shifra dhe fjalë)

69474375

Objekti i kontratës/Marrëveshjes Kuadër

Përshkrimi i shkurtër i punëve/mallrave/shërbimeve objekt kontrate/marrëveshje kuadër.

Loti 1: “Blerje Hipoklorit Natriumi 13-15%”

Afati i fundit për paraqitjen e ofertës

Data (viti/muaji/dita)

2024/01/22

Data e publikimit të Njoftimit të Fituesit

(Data (viti/muaji/dita) nëse është e zbatueshme)

Data e nënshkrimit të kontratës

(Data (viti/muaji/dita) në rastet e kërkesave për pavlefshmërinë e kontratës)

Tipi i kontratës

Data e zhvillimit të procedurës

Mallra

2024/01/22

Numri i njoftimit

Kodi CPV

24962000-5

24962000-5

Ankese mbi argument në KPP

Seksioni III: Përshkrimi i ankesës

1. Baza ligjore

(Shkelje/arsyetime ligjore, bazuar në vendime, akte, dokumente, etj.)

1. Baza ligjore (Shkelje ligjore, bazuar në vendime, akte, dokumente, etj.)

Ligji nr.162/2020, date 23.12.2020, “Per Prokurimit Publik”

Vendim nr.914 date 29.12.2014 te Keshillit te Ministrave “Per miratimin e rregullave te Prokurimit Publik”, i ndryshuar me vendim nr.402, date 13.05.2015, me vendim nr.823, date 23.11.2016, me vendim nr.797, date 29.12.2017 dhe me vendim nr.80, date 14.02.2018 dhe me vendim nr.823, date 21.10.2020

Neni 2

Qëllimi

Qëllim i këtij ligji është:

- a) të rrisë efikasitetin dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik;
 - b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale;
 - c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik;
 - ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë;
 - d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik;
 - dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik.
-

2. Objekti i ankesës

- Modifikim i dokumentave të tenderit

- Kundërshtim i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave lidhur me skualifikimin e ofertës tuaj.

(Citoni këtu arsyet e skualifikimit)

- Kundërshtim i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave lidhur me kualifikimin e ofertës të një/disa operatori/ëve ekonomikë pjesëmarrës në procedurën e prokurimit.

(Citoni operatorin/ët ekonomik për të cilin keni pretendime)

- Pavlefshmëri kontrate

(Citoni kontratën për të cilën kërkoni pavlefshmërinë)

- Tjetër

(Citoni këtu objektin e ankesës që nuk përfshihet më sipër)

3. Rrethanat dhe faktet □

Përshkruani rrethanat e faktit. □

Brenda afatit ligjor të parashikuar në Nenin 110, Nenin 111, të LPP, duam të paraqesim këtë ankesë përpara Autoritetit Kontaktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik në lidhje me skualifikimin e bërë nga ana e Autoritetit Kontraktor për Operatorin të Ekonomik.

1. Operatori ekonomik ankues dërgon njëkohësisht ankesën në autoritetin ose entin kontraktor dhe Komisionin e Prokurimit Publik.

Rregulla të posaçme për mënyrën e paraqitjes së ankesës përcaktohen në rregullat e prokurimit publik.

Bazuar në dispozitën ligjore të mësipërme, brenda afateve të përcaktuara nga neni i mësipërm, ne ju paraqesim ankesën e mëposhtme.

Të nderuar anëtarë të Komisionit të Prokurimit,

Në datën 20.12.2023 Autoriteti Kontraktor Ujësjiellës Kanalizime Tiranë ka hedhur në sistemin e APP procedurën e prokurimit me objekt Blerje Hipoklorit Natriumi 13-15%

Ne si Operator Ekonomik, i interesuar duam të paraqesim argumentat tona në lidhje me kriteret abuzive që janë vendosur nga AK për të favorizuar të njetin Operator Ekonomik i shpallur fitues herën e fundit.

Neni 2

Qëllimi

Qëllim i këtij ligji është:

- a) të rrisë efikasitetin dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik;
- b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale;
- c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik;
- ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë;
- d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik;
- dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik.

4. Argumentime mbi shkeljet e pretenduara

Përshkruani në mënyrë koncize shkeljet e pretenduara, duke argumentuar qartë dhe saktë se përse pretendoni për paligjshmëri në veprimet e autoritetit/entit kontraktor.

Shtojca 5

2. Treguesit cilësor dhe karakteristikat kimike të kimikateve

Treguesit e cilësisë dhe karakteristikat kimike të produkteve të ofruara nga firmat konkurrese duhet të plotësojnë parametrat e cilësisë dhe sigurisë si më poshtë : (gjëni bashkëgjatur Tabelen)

Specifikimet janë hartuar në përputhje me Standartet Shtetërore Shqiptare përkatëse konkretisht :
Acidi Klorhidrik S SH EN 939 : 2009, Polikloruri i Aluminit S SH EN 17034: 2018, Hipokloriti i Natriumit S SH EN 901: 2013.

Lidhur me specifikimet teknike kërkojmë që të modifikohet standarti duke u vendosur në përputhje me Standartet Shtetërore Shqiptare të njohura nga Instituti i Shëndetit Publik (ISHP) dhe Ministria e Shëndetësisë (S SH EN 901:1999 , S SH EN 901 2007) dhe të vendosen ato elementë që ISHP analizon (arsyet sepse i gjëni të analizuar në kriterin 2.11).

3. Specifikat e automjetit që do të shërbejë për furnizimin e kimikateve

Furnizimi me kimikate do të kryhet me mjete tip bot të çertifikuara për transportin e lëndëve të rrezikshme sipas standartit të BE. Çisternat e destinuar për transportin e kimikateve duhet të jenë të përshtatshme për të mbajtur prodhim të destinuar për trajtimin e ujit të pijshëm. Ato nuk duhet të kenë transportuar më parë substanca të dëmshme ose të konsideruara si të tilla për ndotjen e ngarkesës së kimikatit. Për furnizimin e Impiantit të Bovillës me Hipoklorit Natriumi, Acid Klorhidrik dhe Poliklorur Alumini, mjetet tip bot duhet të jenë të përshtatshme për secilin nga kimikatet dhe të kenë kapacitet mbajtës nga 22.000-26.000 kg. Për furnizimin e Depove të ujit me Hipoklorit Natriumi, mjeti tip bot duhet të ketë kapacitet mbajtës 10.000-15.000 kg.

Gjithashtu për transportin e këtyre kimikateve mund të përdoren depozita 1000 l IBC (intermediate bulk container) të jete të vulosura, të pajisura me certifikatat e testimit dhe certifikatat ADR për secilen depozitë, dhe të miratura në përputhje me dispozitat ADR sipas ligjit Nr. 118/2012 "PËR TRANSPORTIN E MALLRAVE TË RREZIKSHME" për arsye se këto kimikate klasifikohen si produkt ADR me kodet si më poshtë

Kodi UN1791, ADR 1791 solucion HIPOKLORIT NATRIUMI

Kodi UN1789, ADR 1789 solucion ACID KLORHIDRIK

Kodi ADR 3264 solucion POLIKLORUR ALUMINI

Kamioni që transporton kimikatet me këto depozita 1000 l duhet gjithashtu të jete i pajisur me certifikate (ADR) për transport lëndesh të rrezikshme (KIMIKATE).

5. Dokumentacioni shoqëruar i çdo ngarkese të kimikateve të trajtimit të ujit me të cilën do të furnizohet Impianti Bovillë.

Firma furnizuese përpara se të realizojë shkarkimin e kimikateve për çdo ngarkesë të dorëzuar duhet

të paraqesë dokumentacionin e mëposhtëm

3-Raport Analizën të lëshuar nga Inspektoriati Sanitar Shtetëror , në origjinal. Në rastin kur transporti do të kryhet me depozita 1000 l atëherë duhet që cdo depozitë të jete shoqëruar me flete-analize.

Lidhur me Shtojcën 5 pika 5.3

Raport Analizën të lëshuar nga Inspektoriati Sanitar Shtetëror , në origjinal. Në rastin kur transporti do të kryhet me depozita 1000 l atëherë duhet që cdo depozitë të jete shoqëruar me flete-analize. Operatori ekonomik gjykon se duke qënë se të gjitha depozitet mbushen nga e njëjta parti malli nuk është e nevojshme të analizohen të gjitha vec e vec duke marrë parasysh se cdo fletë analizë pranë Inspektoriatit Sanitar Shtetëror ka një kosto ekonomike. Ndërkohë gjykojmë që është mëse e mjaftueshme që mostra të merret nga secila depozitë dhe të analizohet e gjitha bashkë, pra më një fletë analizë dhe kjo eliminon kostot e panevojshme për të testuar secilën mostër vec e vec!

Kërkesa të tjera të veçanta për kualifikim

2.4. Operatori ekonomik duhet të paraqesë:

- Autorizim nga prodhuesi ose distributori i autorizuar nga prodhuesi për mallrat e kërkuar nga Autoriteti Kontraktor . Në rast se do të paraqitet kjo e fundit duhet të vertetohet lidhja midis distributorit të autorizuar dhe prodhuesit. Autorizimi duhet të përmbajë të dhëna të plota të prodhuesit si: telefon, fax, e-mail, ëb-site, kjo e nevojshme për Autoritetin Kontraktor në rast verifikimi nga ana e tij.

Përsa i takon këtij kriteri operatori jonë ekonomik furnizohet nga një distributor i autorizuar i cili nuk lidhur drejt për drejt me prodhuesin por me një distributor tjetër të autorizuar i cili është i lidhur drejt për drejt me prodhuesin, për këtë arsye lidhja është e pamundur dhe për këtë arsye duhet të pranohet vetëm autorizimi i distributorit tonë të autorizuar dhe operatorit tonë ekonomik.

Autorizim jonë tejkalon sasi të e kërkuara nga kjo procedurë prokurimi (gjeni bashkangjitur)
Për sa më sipër kërkojmë modifikimin e këtij kriteri, duke pranuar ose autorizimin e prodhuesin
ose autorizimin e distributorin e autorizuar.

Gjithashtu KPP po per te njejtën procedure prokurimi me te njejtin dhe mall te ngjashem objekt
prokurimi eshte shprehur me vendim:

Vendim: 1260/2022. Date 16.12.2022

Vendim: 159/20221. Date 09.04.2021

2.7 Operatori ekonomik ofertues duhet të jetë i Certifikuar sipas standardeve ISO të lëshuara nga
organizmat e vlerësimit të konformitetit të cilat janë të akredituara nga DPA ose nga organizmat
ndërkombëtare akreditues të njohur nga Republika e Shqipërisë, konkretisht:

a) Të disponojë Çertifikatën SSH 45001:2018 e vlefshme mbi “Sistemin për Menaxhimin e
Sigurisë dhe Shëndetit në Punë”. (Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomik, çdo anëtar i
grupit duhet të paraqesë Çertifikatën ISO sipas zerave që do të marre persiper sipas
akt-marreveshjes).

ISO 18001: 2007 i ndryshuar me ISO 45001 : 2018 , kriteri i përcaktuar nga autoriteti kontraktor
mbi paraqitjen e Çertifikatës 45001:2018 ose ekuivalente së saj për një sistem manaxhimi të
shëndetit dhe sigurimit në punë, referuar procedurës objekt ankimi gjykon se kjo kërkesë është e
ekzagjeruar. Certifikata 45001:2018 ose ekuivalente e saj garanton sigurinë dhe shëndetin në punë
të punonjësve që marrin pjesë gjatë një procesi prodhimi apo kryerjes së një veprimtarie e cila vë
apo mund të vërë në rrezik shëndetin dhe jetën e punonjësve. Në rastin konkret referuar objektit të
prokurimit mund të marrin pjesë përveç kompanive prodhuese të cilat e kanë të detyrueshme
certifikimin me 45001:2018 edhe kompani të cilat kanë për objekt të veprimtarisë së tyre vetëm
tregtimin e produkteve objekt prokurimi. Në këtë kuptim Komisioni gjykon se për shoqëritë të cilat
kanë për objekt veprimtarie vetëm tregtimin e produkteve që do të prokurohen nuk kanë
domosdoshmërisht detyrimin të pasjisen me certifikatën 45001:2018. Kërkesa e autoritetit
kontraktor për disponimin nga ana e operatorëve ekonomikë të certifikatës 45001:2018 ose
ekuivalente duhet të hiqet nga kriteret për kualifikim. Vendosja e një kriteri të tillë ndikon në uljen e
konkurrencës midis operatorëve ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit, gjithashtu nuk
është në proporcion me objektin e prokurimit dhe në funksion të realizimit me sukses të tij.
Kriteret për kualifikim duhet të hartohen në përputhje me LPP-në dhe rregullat e prokurimit publik
në mënyrë të tillë që të nxisin pjesëmarrjen dhe konkurrencën e operatorëve ekonomikë, të
stimulojnë pjesëmarrjen e biznesit të vogël dhe të mesëm, si dhe të sigurojnë një trajtim të
barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në këto procedura.

Gjithashtu KPP po per te njejtën procedure prokurimi me te njejtin dhe mall te ngjashem objekt
prokurimi eshte shprehur me vendim:

Vendim: 12/2021, Date 12.01.2021

Vendim: 106/2021, Date 26.02.2021

Vendim: 136/2021, Date 26.03.2021

Vendim: 301/2021, Date 21.06.2021

Vendim: 66/2023, Date 31.01.2023

2.8.Në rast se operatori ekonomik ofertues nuk është prodhues operatori ekonomik pjesëmarrës
duhet të paraqesë vetëdeklarim me anë të së cilës duhet të deklarojë se mallrat janë konform

normave SSH EN 901;2013).

Autoriteti Kontraktor rezervon të drejtën për verifikimin e vetëdeklarimit në procesin e vlerësimit të dokumentacionit në sistemin elektronik.

Shënim: Ndërsa operatori ekonomik i kualifikuar i pari duhet të dorëzojë pranë AK, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve ankimit, çertifikatën e prodhuesit konform normave, SSH EN 901;2013).

Lidhur me këtë kriter duke theksuar edhe një herë që ne si operator ekonomik kemi lidhje jo me prodhuesin por me një distributor të autorizuar, nuk mund të posedojmë certifikatën e prodhuesit por deklaratën e distributorit që mallrat janë Konform normave SSH EN 901; 2013 (gjeni bashkangjitur autorizimin conform SSH EN 901;2013).

Për sa më sipur kërkohet që dorëzimi i këtij dokumenti nga ana jonë most ë jetë kusht për skualifikim.

2.9 Operatori ekonomik ofertues (ne rastin kur nuk ehte prodhues) duhet të paraqese ne sistemin elektronik nje vetedeklarim me anë të së cilit duhet të deklarojë se në momentin e dorëzimit të mallit do të dorëzojë pranë Autoritetit Kontraktor certifikatën nr.Rech të prodhuesit i cili vërteton dhe identifikon se prodhuesi(t) është i rregjistruar dhe i çertifikuar për tregtimin e produkteve kimike për trajtimin e ujit për konsumim njerëzor.

Autoriteti Kontraktor rezervon të drejtën për verifikimin e vetëdeklarimit në procesin e vlerësimit të dokumentacionit në sistemin elektronik.

Lidhur me certifikatën nr. Rech kjo e dhënë është e përcaktuar qartësisht në skedën e sigurisë të mallrave objekt prokurimi dhe për këtë arsye dorëzimi i certifikatës nr. Rech më vete e gjykojmë si të panevojshëm dhe të vendosur qëllimisht për të krijuar mundësi për paqartësi dhe mundësi skualifikimi të paarsye të operatorëve ekonomik, të cilët nuk kanë informacionin e nevojshëm për të shpjeguar që nr. Rech gjendet i përcaktuar qartë ne skeden e sigurisë te mallit objekt prokurimi e cila porëzohet në momentin e dorëzimit të mallit tek shtojca 5, pika 5.5 (gjeni bashkangjitur skeden sigurisë faqe 1 (sezione 1) ku sitohet nr i regjistrimit/nr rech: 01-2119488154-34-XXXX) Për sa më sipër kërkohet që ky kriter të hiqet pasi gjendet në skedën e sigurisë që do të dorëzohet gjatë dorëzimit të mallit.

2.10. Në rast se operatori ekonomik është importues atëherë duhet të paraqesë në sistemin elektronik lejen e importit të lëshuar nga Komisioni i Liçensave pranë Ministrisë së Shendetësisë për llojet e sasitë e kimikateve të përcaktuara në DST.

Në rast se operatori ekonomik është prodhues vendas atëherë duhet të paraqesë në sistemin elektronik leje mjedisore e tipit A të lëshuar nga QKL për të gjitha kimikatet e kërkuara nga AK.

Në rast se operatori ekonomik është tregtues vendas atëherë operatori ekonomik duhet të paraqesë në sistemin elektronik kontratë furnizimi me një prodhues vendas shoqëruar me lejen mjedisore e tipit A të lëshuar nga QKL të prodhuesit vendas ose kontratë furnizimi me 1(një) importues të mallrave si dhe lejen e importit të importuesit të lëshuar nga Komisioni i Liçensave pranë Ministrisë së Shendetësisë për llojet e sasitë e kimikateve të përcaktuara në DST.

Kuadri ligjor parashikon licencimin e subjekteve që ushtrojnë aktivitetin e importimit, eksportimit, magazinimit dhe tregtimit me shumicë e pakicë, ndërkohë që pjesëmarrës në procedurën e prokurimit mund të jenë edhe subjekte të tjera të cilat përmbushin kriteret e veçanta të kualifikimit, por nuk përfshihen në kategoritë e mësipërme. Ndër parimet kryesore të zhvillimit të procedurës së prokurimit janë ato të transparencës dhe trajtimit të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik. Referuar sa më lart, autoriteti kontraktor duhet të modifikojë kriterin e veçantë të kualifikimit, duke e përshtatur atë me

dispozitat ligjore në fuqi dhe me qëllim edhe nxitjen e pjesëmarrjes së biznesit të vogël dhe rritjes së konkurrencës, duhet të cilësojë në kriter se leja e importit do të bëhet e kërkueshme në rastin kur ofertuesi shfaqet në cilësinë e importuesit të produkteve të mallit objekt-prokurimi

Gjithashtu KPP po për të njëjtin procedurë prokurimi me të njëjtin dhe mall të ngjashëm objekt prokurimi është shprehur me vendim:

Vendim: 66/2023, Date 31.01.2023

2.11 Operatori ekonomik duhet të paraqesë në sistemin elektronik fletën e analizës nga Instituti i Shëndetit Publik për analizat si më poshtë :

Ngjyra dhe Era, Plumbi(Pb), Kadmiumi (Cd), Kromi (Cr), Nikeli(Ni), Densiteti ose Analizimi i metaleve të rënda të kimikateve të bëhet në një laborator të licensuar (vëndas ose të huaj), Qendër Kërkimore (IKV,IFBZ) apo Universitare që ka kapacitete dhe aparaturë të analizojë metalet e rënda në produkte të ndryshme, përfshirë dhe kimikatet e siperpermendura.(Për të gjithë elementet të cilët nuk kryhen nga Instituti i Shëndetit Publik)

Se pari: “Densiteti” i kërkuar tek fletë analiza e Institutit të Shëndetit Publik, për mallin objekt prokurimi nuk kryet nga Instituti i Shëndetit Publik.

Se dyti: Bashkangjitur gjëni përgjigjet e dy institucioneve të cilët AK ka cituar si laborator vëndas (IKV dhe IFBZ) për kryerjen e analizës toksikologjike. Në përgjigjen e tyre drejtuar Operatorit tonë ekonomik, shprehen qartë se ata nuk kryejnë analiza toksikologjike për produktet mall objekt prokurimi. Kërkojmë nga AK shkresën ose informacionin mbi të cilin ata janë bazuar për të cituar këto dy insitucione (IKV dhe IFBZ) si laboratorë të licensuar për kryerjen analizave toksikologjike të kërkuara.

A ka AK informacion shkresor që këto 2 insitucione i kryejnë këto analiza?

Sepse një AK duhet të ketë informacion të bayuar në shkresë për të përpiluar një kriter të vecantë kualifikimi dhe jo të marrë përsipër të vendosë kriteret të pa dokumentuar ose vërtetuar me fakte, sikurse rezulton të ketë vepruar në rastin e këtyre dy institucioneve.

Po kështu operatori jonë ekonomik gjykon se analiza e ISHP është e mjaftueshme për tu kualifikuar në procedura me këto mallra objekt prokurimi për sa kohë që edhe vetë AK në Shtojcën 5, pika 5. Dokumentacioni shoqëruar i çdo ngarkese të kimikateve të trajtimit të ujit me të cilën do të furnizohet Impianti Bovillë. 4-Të paktën një herë në tre muaj, analizën e parametrave të sigurisë të analizuar në Institutin e Shëndetit Publik Tiranë, që përmbledhen tek pikat nr 5 – 12 tek Hipokloriti i Natriumit, Nr 5 – 14 tek Acidi Kloridrik, Nr 6 – 13 tek Polikloruri i Aluminit sipas mostrave të zgjedhura rastësisht nga komisioni i kolaudimit., kërkon analizën e ISHP me vetëm ato parametra që ky institucion analizon.

Në vazhdim të gjykimit tonë se pse analiza e ISHP është e mjaftueshme për një operator ekonomik për tu kualifikuar lidhet drejtpërdrejt me Ministrinë e Shëndetësisë, institucioni përgjegjës i cili na pajis me Autorizim Importi (leje importi, ashtu sic është kërkuar në kriterin Nr 4 të DST, vendosur nga AK. Ky kriter lidhet drejtpërdrejt me analizën toksikologjike të ISHP, në varësi të përgjigjes së kësaj analize një operator ekonomik ka të drejtë për të importuar dhe nxjerrë në treg këto biocide (Hipoklorit Natriumi, Hipoklorit Kalciumi, Karbon Aktiv etj) të cilat shërbejnë për përdorim human, saktësisht për trajtimin e ujit të pijshëm.

Mbështetur në sa më sipër në bazë të Vendimit Nr 933, date 25.11.2020,

“Për përcaktimin e rregullave për kriterete vlerësimit të produkteve Biocide dhe të procedurës së dhënies së autorizimit të vendosjes së tyre në treg”

Kreu II, Pika 5, faqa 4, në rastet kur përmbushen kërkesat e pikës 4 të këtij krey, dosja me dokumentacionin teknik në formë elektronike (CD), i dregohet për vleresim Institutit të Shëndetit Publik (ISHP), brenda 25 diteve nga datja e marrjes në dorëzim të dosjes.

Kreu II, Pika 6, faqa 4, Instituti i Shëndetit Publik (ISHP), si strukturë ë specializuar bën vlerësimin e produktit/ve dhe biocid/e bazuar në informacionin e paraqitur në dosje që përfshin: rezultatet e studimeve toksikologjike dhe efektivitetit të lëndës vepruese dhe të përbërësve të tjerë si edhe ndikim në mjedis, simbolet, frazat e riskut dhe sigurisë, klasifikimin, etiketimin dhe paketimin në përputhje me legjislacionin në fuqi për kimikatet dhe biocidet si dhe dokumentin e të dhënave të sigurisë së kimikateve (MSDS)

Shtojca 1, “Kriteret e vlerësimit të produkteve biocide dhe procedura e dhënies së autorizimit të vendosjes në treg të produkteve biocide”.

Kreu I, pika 7, Pas shqyrtimit të dokumentacionit të aplikimit, Insituti i Shëndetit Publik, përgatit Raportin e vlerësimit për vendosjen në treg të produktit biocid dhe e dërgon atë pranë Sekretariatit brenda 30 ditëve.

Mbështetur në sa më sipë në i jemi drejtuar Ministrisë së Shëndetësisë me dokumentacionet përkatëse për tu pajisur me leje importi për mallrat objekt prokurimi. Ministria e Shendetësisë i është drejtuar Institutit të Shëndetit Publik (ISHP), si autoriteti i vetëm i specializuar për vlerësimin e këtij produkti nëpërmjet analizës toksikologjike (vetëm me ato 4 parametra që ISHP mund të analizojë) nëse plotëson kushtet për përdorim human apo jo, dhe në varësi të përgjigjes së analizës së ISHP, Ministria e Shëndetësisë pajis me autorizimin për të importuar dhe për ta tregtuar në tregun vendas me qëllim përfundimtar përdorim human. Mbështetur në këtë arsyetim ISHP me anë të analizës toksikologjike i jep Ministrisë së Shëndetësisë të drejtën për të na pajisur në me leje importi për të tregtuar brenda vendit mallrat objekt prokurimi. AK nuk ka tagrin ligjor të kundështojë një analizë toksikologjike dhe vendimin e Ministrisë së Shëndetësisë, të cilat nëpërmejt kësaj analize konfirmojnë që malli përmbush parametrat e kërkuara në Republikën e Shqipërisë dhe na lejojë ne ta tregtojmë këtë mall brenda vendit për përdorim human, theksojmë se marrëdhënie tregtare realizon edhe procedura e prokurimit publik.

Arsyetimi i dytë lidhet drejtpërdrejt me të parin, pasi ndër vite ISHP ka bërë të njëjtën analizë për mallrat objekt prokurimi dhe AK nuk ka ngritur ndonjëherë këtë pretendim që kjo analizë është e paplotë për fituesit e viteve më parë (kërkojmë nga ju të verifikohen fletë-analizat e dorëzuara nga operatorët fitues për vitet 2021-2020-2019-2018-2017).

Analizën e ISHP ky AK e ka pranuar gjithmonë pasi në Republikën e Shqipërisë është i vetmi autoritet i specializuar sikurse thekson edhe Ministria e Shëndetësisë. AK nuk mund të dalë sipër autoriteteve që kanë të drejtë të shprehen lidhur më parametrat që plotësojnë këto produkte dhe të marrë kompetenca që si takojnë duke u shprehur mbi ISHP dhe Ministrinë e Shëndetësisë. Thënë kjo AK ka vepruar në mënyrë të qëllimshme duke përdorur këtë arsyetim të pa bazë dhe në kundërshtim të hapur me veten dhe autoritetet përgjegjëse të përcaktuar me ligj.

Autoriteti kontraktor e pranon faktin se Instituti i Shëndetit Publik është organi përgjegjës i ngarkuar me ligj për kryerjen e analizave toksikologjike për parametrat që duhet të plotësojë artikulli “Acid Klorhidrik, Hipoklorit Natriumi, Poliklorur Alumini” përpara se të përdoret për të trajtuar ujin e pijshëm për përdorim për popullatën, por duke qënë se disa analiza laboratorike të disa parametrave toksikologjik të përcaktuara në shtojcën 5 të dokumentave të tenderit nuk mund të bëhen nga ky institut autoriteti kontraktor sipas parashikimeve të nenit 40të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar ka parashikuar mundësinë që këto analiza të kryehen edhe nga laboratorë të tjerë shtetëror apo privat të akredituar

në Republikën e Shqipërisë, por duke patur parasysh pretendimet e ankimuesit edhe ky përcaktim nuk është gjithëpërfshirës dhe i mjaftueshëm për të siguruar pjesmarrjen sa më të gjërë të operatorëve ekonomikë në këtë procedurë prokurimi, pasi në këtë rast enti prokurues duhet të parashikonte edhe mundësinë që këto analiza të kryhen edhe nga laboratorë të huaj të akredituar për kryerjen e këtyre analizave.

Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se autoriteti kontraktor është në të drejtën e tij për të përcaktuar kritere dhe specifikime teknike në lidhje me artikujt objekt-prokurimi, por në çdo rast këto specifikime teknike dhe kritere duhet të jenë në proporcion me natyrën dhe volumin e kontratës që prokurohet, si dhe duhet të jenë të justifikuara teknikisht bazuar në fakte dhe prova konkrete, pasi vendosja e kritereve të pajustificuara shkakton kufizime dhe përjashtime tërësisht të panevojshme nga pjesëmarrja në procedurë e operatorëve ekonomikë të interesuar. Gjykon se ndonjëse autoriteti kontraktor ka përcaktuar qartë kërkesën që ofertuesit të paraqesin fletë analize të lëshuar nga Insituti i Shëndetit Publik për ato parametra toksikologjik që i realizon ky institut dhe për analizën toksikologjike të parametave që nuk kryhen nga ky i fundit autoriteti kontraktor duhet të përcaktojë organizmat ose institucionet konkrete private ose shtetërore të akredituar vendase ose të huaja të cilat mund të kryejnë këto lloj analizash toksikologjike. Gjithashtu në përcaktimin e këtyre organizmat ose institucionet konkrete private ose shtetërore të akredituar vendase ose të huaja autoriteti kontraktor duhet të mbështetet dhe në përvojën e viteve të mëparshme lidhur me realizimin e këtyre lloj analizash toksikologjike. Përsa më sipër autoriteti kontraktor duhet të modifikojë kriterin e sipërpërmendur, duke përcaktuar qartë organizmat ose institucionet konkrete private ose shtetërore të akredituar vendase, ndersa për institucionet e huaja që kanë kapacitete për kryerjen e këtyre lloj analizash toksikologjike nuk ka referuar asnjë laborator konkret ku mund të drejtohem, por edhe sikur të kishte referuar ndonjë prej tyre afatet kohore nuk mjaftojnë pasi operatorët ekonomikë duhet të shkojnë fizikisht në këto laboratorë, të cilat ndodhen jashtë Republikës së Shqipërisë, për të dorëzuar mostrat dhe ndërkohën analizimi i elementeve toksikologjike kërkon kohën e caktuar e cila tejkalon afatet e procedurës së prokurimit duke përberë kusht për skualifikim. Po kështu të gjitha këto janë kosto të tepërta financiare për operatorët ekonomikë.

Gjithashtu KPP për të njejtin AK “Ujesjelles Kanalizime Tirane” po për të njejtën procedurë prokurimi me të njejtin dhe mall të ngjashëm objekt prokurimi është shprehur me vendim:

Vendim: 1192/2022, Date 01.12.2022

Vendim: 1194/2022, Date 01.12.2022

Vendim: 1196/2022, Date 01.12.2022

Vendim: 66/2023, Date 31.01.2023

Ndersa AK nuk respekton vendimet që janë dhënë edhe me përpara nga K.P.P

2.12.Një punësim mesatar i të paktën 3(tre) personave, për muajin e fundit të vërtetuar me;

? Vërtetim të lëshuar nga Sigurimet shoqërore ose Administrata Tatimore, ku të specifikohet numri i punonjësve për muajin e fundit;

? List pagesat e punonjësve sipas formatit që kërkohej nga legjislacioni në fuqi për muajin e fundit.

(Nëse operatori ekonomik oferton për lote të vecanta, nr.i punonjësve duhet të korrespondojë numrit të punonjësve të kërkuar në lotin që oferton, ose shumës së loteve që oferton)

Kriteri për të pasur tre punonjës për të marrë pjesë në një procedurë, 6 nëse merr pjesë në dy procedurë dhe 9 nëse merr pjesë në tre, është një kriter i cili nuk lidhet ngushtë me mallin objekt

prokurimi, pasi në rastin e operatorit tonë ekonomik në jemi tregëtues i mallit objekt prokurimi, madje në rastin konkret ne nuk do të bëjmë as transportin e mallit (pasi atë do të na e sigurojë vetë furnitori) dhe as magazinimin e mallit pasi furniortri jonë merr përsipër transportin e mallit në pikat e magazinimit të përcaktuar nga AK sipas grafikut të lëvrimit që do të vendoset nga vetë AK..

Për sa më sipër kriteri që përcakton numrin e punonjësve që duhet të ketë OE është i panevojshëm dhe nuk ka asnjë efekt në ecurinë e procedurës së prokurimit në asnjë fazë të saj.

2.13. Operatorët ekonomike pjesëmarrës duhet të kenë në stafin e tyre të paktën 1 (një) kimist dhe një drejtues mjete (brenda numrit të kërkuar në pikën 2.12).

- Për punonjës të "Kimist" operatori ekonomik duhet të paraqesë diplomë, dhe kontratë pune (e vlefshme për të paktën periudhën e parashikuar)

Kjo kërkesë në rastin e ofertuesve që nuk janë prodhues por janë tregtues të produktit objekt-prokurimi është i ekzagjeruar, pasi nuk është e lidhur ngushtë me fazën e paraqitjes së ofertës, por fazën e zbatimit të kontratës, prandaj autoriteti kontraktor duhet të marrë masa për modifikimin e këtij kriteri, duke përcaktuar vetëm mundësinë që operatorët ekonomikë ofertues të kenë mundësinë për të disponuar një punonjës me profesionin kimist sipas formës ligjore të parashikuar në legjislacionin përkatës dhe për të gjithë periudhën e zbatimit të kontratës, si dhe duke hequr kërkesën që ky punonjës të figurojë i punësuar në listëpagesën e shoqërisë.

Gjithashtu KPP për të njëjtin AK "Ujesjelles Kanalizime Tirane" po për të njëjten procedurë prokurimi me të njëjtin dhe mall të ngjashëm objekt prokurimi është shprehur me vendim:

Vendim: 1192/2022, Date 01.12.2022

Vendim: 1194/2022, Date 01.12.2022

Vendim: 1196/2022, Date 01.12.2022

Vendim: 66/2023, Date 31.01.2023

Ndërsa AK nuk respekton vendimet që janë dhënë edhe me përpara nga K.P.P

- Për punonjës të "Drejtues mjete" dokumentat që duhet të paraqes janë: Leje drejtimi për mjete që kryejn transportin e lëndëve të rrezikshme (ADR) (e vlefshme) si dhe të figurojë në listëpagesat e muajit të fundit të shoqërisë.

Për rastin kur mjetet dhe makineritë sigurohen nëpërmjet kontratës së qerasë atëherë operatori ekonomik për punonjës të "Drejtues mjete" duhet të paraqesë kontratë punësimi për vetëdeklarimet mbi punonjës të kërkuar në DST.

(Nëse operatori ekonomik oferton për lote të vecanta, nr. i punonjësve duhet të korrespondojë numrit të punonjësve të kërkuar në lotin që oferton, ose shumës së loteve që oferton)

Duke qënë së ky kriter lidhet ngushtë me kriterin 2.14, gjëni arsyetimin tek kriteri 2.14. Kërkojmë modifikimin e këtij kriteri.

2.14 Operatori ekonomik për Loti 1 "Blerje Hipoklorit Natriumi 13-15%", duhet të ketë në pronësi ose me qera 2 mjete (autobot) të autorizuar për transport kimikatesh Gjithashtu për transportin e këtyre kimikateve mund të përdoren depozita 1000 l IBC (intermediate bulk container) të jenë të vulosura, të pajisura me certifikatat e testimi dhe certifikatat ADR për secilën depozitë, dhe të miraturohen në përputhje me dispozitat ADR sipas ligjit Nr. 118/2012 "PËR TRANSPORTIN E MALLRAVE TË RREZIKSHME" për arsye se këto kimikate klasifikohen si produkt ADR me

kodet si me poshte

Kodi UN1791, ADR 1791 solusion HIPOKLORIT NATRIUMI

Kamioni qe transporton kimikatet me keto depozita 1000 l duhet gjithashtu te jete i pajisur me certifikate (ADR) per transport lendesh te rrezikshme (KIMIKATE).

Nëse operatori ekonomik oferton për më shumë se një lot, duhet të vetëdeklarojë, se disponon mjete transporti për secilin nga kimikatet që do të transportojë, sipas specifikimeve teknike të kërkuara për këtë procedurë prokurimi.

Së pari: Për sa i takon kriterit 2.14 në lidhje me të paturin në pronësi ose me qera të një autoboti ose automjeti, operatori jonë ekonomik nuk ka në pronësi dhe as me qera anjë autobus ose automjet pasi furnitori jonë na siguron transportin e mallrave objekt prokurimi me autobus ose automjetet e transportuesit të tij dhe ne nuk e kemi të nevojshme të kemi në pronësi ose me qera autobus ose automjet (gjeni bashkelidhur deklaratën doganore në të cilën shihet qartë në pikën 12 Detajet e vlerës dhe pikën 20 Kushtet e lëvrimet, CPT, Tiranë AL që transporti sigurohet nga furnitori, ndërsa në pikën 18 dhe 21 dallohen targat e autobusit. Po kështu furnitori jonë merr përsipër të sjelle mallrat objekt prokurimi sipas vendodhjeve të përcaktuara në Shtojcën 5.

Kriteri 2.14 dhe kriteri 2.13 pika janë kritere të ekzagjeruara të cilat tejkalojnë kompetencat e AK duke marrë përsipër të bëjë rolin e autoriteteve të Qarkullimit Rrugor dhe Transportit Rrugor të cilët kanë tagrin ligjor dhe strukturat përkatëse për të kontrolluar, inspektuar dhe penalizuar, nëse automjetet ose autobuset qarkullojnë në rrugët e Republikës së Shqipërisë brenda kushteve të ADR ose jo.

Ndërkohë AK duhet të kërkojë vetëm ato të drejta që i lindin nga momenti që malli objekt prokurimi magazinohet në ambjentet e tij, pra nëse malli përmbush specifikat e kërkuara nga AK, dhe jo të marrë përsipër të kryejë kompetenca të insitucioneve të tjera në të cilat AK nuk është palë, pasi kjo është një marrëdhënie dy palëshë mes operatorit ekonomik dhe autoriteteve të qarkullimit dhe transportit rrugor. Thënë kjo detyrimet që ka operatori ekonomik ndaj autoriteteve të qarkullimit rrugor janë përgjegjësi e operatorit ekonomik jo e AK, e cila tejkalon kopetencat e veta. Edhe pse operatori jonë ekonomik importon mallrat objekt prokurimi dhe si rrejdhim automjetet dhe depozitat janë të pajisur me certifikime ADR pasi ne të kundërt nuk do të kalonin procedurën e eksportit dhe importit në doganat respektive që realizojnë eksportin dhe importin e këtyre mallrave objekt prokurimi, kjo pasi ligji i ADR është një kusht i vendosur nga vetë Bashkimi Evropian.

Thënë kjo duke qënë se ADR është një detyrim ligjor për transportuesit nuk është e nevojshme që të vendoset si kriter nga AK dhe as të diskutohet për sa kohë certifikimi ADR është kusht ligjor për trasportimin e lëndëve të rrezikshme (Kimikate).

Po kështu kriteri 2.13 Për punonjësin “Drejtues mjeti” dokumentat që duhet të paraqes janë: Leje drejtimi për mjete që kryejn transportin e lëndëve të rrezikshme (ADR) (e vlefshme) si dhe te figurojë në listpagesat e muajit të fundit të shoqerisë. Për punonjësin “Drejtues mjeti” dokumentat që duhet të paraqes janë: Leje drejtimi për mjete që kryejn transportin e lëndëve të rrezikshme (ADR) (e vlefshme) si dhe te figurojë në listpagesat e muajit të fundit të shoqerisë., në rastin e operatorit tonë ekonomik drejtuesi i mjetit do të jetë një punonjës i kompanisë ndërkombëtare që do të realizojë transportin e mallit, për këtë arsye kriteri duhet të ndryshohet duke përfshirë vetëm ato raste kur drejtuesi i mjetit është punonjës i OE.

Duke qënë se në transportin do të na e sigurojë furnitori jonë, dhe nëse është e nevojshme ne mund t’iu vemë në dispozicion një deklaratë nga furnitori jonë i cili merr përsipër transportin e mallit në pikat e magazinimit të kërkuara nga AK, thënë kjo ne si OE automatikisht përjashtohemi nga detyrimi për të përmbushjen e kriterit 2.13, 2.14 dhe Shtojca 5 pika 3 Specifikat e automjetit që do të shërbejë për furnizimin e kimikateve.

Në përfundim, për sa mësipër gjykojmë se kriteret e argumentuara nga ana jonë janë kritere abuzive të vendosura qëllimisht për të avantazhuar operatorë ekonomik të cilët për vite me rradhë

kanë përfituar këto kontrata publike duke shkeluar cdo parim të LLP, gjithashtu kriteret e sipërcituara janë vendosur sërish nga kjo AK edhe pse në vendimet tuaja të mëparshme ju i keni kërkuar këtij AK dhe AK-ve të tjera t'i heqin nga DST.

Për këtë arsye kërkojmë që këto kriteret të hiqen ose të modifikohen duke përfshirë edhe situacionin e operatorit tonë ekonomik.

5. Kërkesë për ekspertizë të posaçme

Po

Jo

(Nëse po, specifikoni llojin e ekspertizës që kërkon)

6. Kërkesë për përjashtim të zyrtarëve që do të merren me shqyrtimin e ankesës:

Nuk kemi

7. Lista e informacionit konfidencial:

Nuk kemi

Përcaktoni se cili informacion është konfidencial, nëse ka. Shpjegoni pse informacioni është ose një version i dokumenteve përkatëse me heqjen e pjesëve konfidenciale dhe një përmbledhje të përmbajtjes.

Kujdes: Ankimesi duhet t'i bashkëlidhë ankimit, që do të paraqesë në autoritetin/entin kontraktor dhe Komisionin e Prokurimit Publik, dokumentin bankar që vërteton pagesën e tarifës përkatëse për ankesën pranë Komisionit të Prokurimit Publik

Dërgojeni formularin e plotësuar të ankesës së prokurimit, të gjitha shtojcat e nevojshme dhe kopjet shtesë, pranë **Autoritetit/Enti Kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik**.

Shënim: Ankimuesi duhet ta dërgojë njëkohësisht ankesën në autoritetin/entin kontraktor dhe Komisionin e Prokurimit publik

Nr. i faksit:

E-mail:

info@adchem.al

Nënshkrimi dhe vula e Ankuesit

Administratori/Përfaqësuesi i autorizuar

Mamica Jançe